



**Republika e Kosovës**  
**Komuna e Drenasit (Glllogoc)**  
**Kuvendi i Komunës**

02 Nr. 400/01-54035 dt. 24/12/ 2025



Bazuar në nenin 11,12,dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 46, pika 2, të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 24.12.2025 të miratoi këtë:

**V E N D I M**

**Për miratimin e Planit të Reagimit Emergjent për territorin e Komunës së Drenasit, 2026–2029**

**Neni 1**

Kuvendi i Komunës së Drenasit miratoj Planin e Reagimit Emergjent për territorin e Komunës së Drenasit, 2026–2029.

**Neni 2**

Hartimin e Planit të Reagimit Emergjent e ka bërë Komisioni i caktuar me vendim të Kryetarit të Komunës, në përputhje me Planin Kombëtar të Reagimit Emergjent. Ky plan është hartuar brenda vitit fiskal dhe i njëjti paraqitet para Kuvendit për miratim.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

**Neni 4**

Ky vendim hynë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

## ARSYETIM

Pas skadimit të afatit të Planit të mëparshëm të Reagimit Emergjent për territorin e Komunës së Drenasit, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, paraqitet nevoja për miratimin e një plani të ri.

Ky Plan ka për qëllim të përcaktojë procedurat, mekanizmat dhe përgjegjësitë institucionale për reagim të shpejtë dhe të koordinuar në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ky dokument ka për mbrojtjen e jetës së qytetarëve, pronës publike dhe private, si dhe funksionimin normal të shërbimeve komunale, Kryetari i Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës së Drenasit miratimin e këtij Plan.

Miratimi i Planit të Reagimit Emergjent krijon bazën institucionale për veprim efikas, koordinim ndërinstitutional dhe reagim emergjent të organizuar në territorin e Komunës së Drenasit.